

LIGJ
Nr.7640, datë 11.12.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7516, DATË 7.10.1991 "PËR SINDIKATAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

"Sindikatat janë organizata shoqërore të pavarura që krijohen si bashkime vullnetare të punonjësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe e interesave ekonomike, profesionale e sociale të anëtarëve të tyre.

Organizimi dhe veprimtaria e sindikatave është e lirë dhe e garantuar me ligj".

Neni 2

Pas nenit 1 shtohet neni 1/a me këtë përmbajtje:

"Sindikatat janë organizata shoqërore të pavarura nga punëdhënësi, administrata shtetërore dhe partitë politike.

Në veprimtarinë e tyre ato udhëhiqen nga vullneti i lirë i anëtarëve, duke u mbështetur në Kushtetutë, ligjet, statutin dhe programin e tyre.

Sindikatat janë të detyruara të respektojnë rendin juridik. Ato nuk merren me veprimtari politike".

Neni 3

Pas nenit 3 shtohet neni 3/a me këtë përmbajtje:

"Mënyra e krijimit, funksionimit dhe e shpërndarjes së sindikatave parashikohet në statutin që miratohet nga anëtarët e tyre".

Neni 4

Pas nenit 3/a shtohet neni 3/b me këtë përmbajtje:

"Në statutin e sindikatës duhet të parashikohet:

- a) krijimi, emërimi, qendra e sindikatës dhe territori ku ajo vepron;
- b) kushtet për pranimin dhe daljen e anëtarëve nga sindikata;
- c) të drejtat dhe detyrat e anëtarëve;
- ç) kuotat e anëtarësisë, mënyrat e mbledhjes së tyre dhe burimet e tjera financiare;
- d) organet drejtuese dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre;
- dh) mënyrat e shkrirjes e të shpërndarjes së sindikatës, si dhe mënyrat e likuidimit të pasurisë së saj;
- e) mënyrat e bashkimit të sindikatave në federata sipas degëve e profesioneve, ose në konfederata kombëtare.

Asnjë dispozitë e statutit nuk duhet të vijë në kundërshtim me ligjet dhe Kushtetutën".

Neni 5

Neni 4 ndryshohet si vijon:

"Sindikatat krijohen me kërkesën e mbi 300 punonjësve dhe me miratimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Kërkesa për njohjen e një sindikate i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë dhe duhet të shoqërohet me origjinalin, si dhe me dy kopje të këtyre dokumenteve:

a) procesverbali i krijimit të sindikatës, i nënshkruar nga 300 anëtarë themelues;

b) statuti dhe programi i sindikatës.

Ndalohet përdorimi i emërtimeve të njëjta me organizatat sindikale ekzistuese nga organizatat sindikale që krijohen të reja, ose që shpërdorin emrin e grupimit sindikale ekzistues".

Neni 6

Pas nenit 6 shtohet neni 6/a me këtë përmbajtje:

Çdo sindikatë duhet të paraqesë në Ministrinë e Drejtësisë, 30 ditë pas miratimit të saj dhe në fund të çdo gjashtë muaji, dokumentin që vërteton derdhjen e kuotizacionit në bankë. Mosparaqitja e dokumentit përkatës automatikisht shkakton shpërndarjen e sindikatës".

Neni 7

Neni 9 ndryshohet si vijon:

"Sindikatat me kërkesën e punonjësve kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës dhe të përfaqësojnë në gjyq interesat e tyre, kur nëpërmjet punonjësve dhe punëdhënësve lindin konflikte në lidhje me marrëdhëniet e punës.

Sindikata kanë të drejtë të mbrojnë edhe interesat ekonomike të punonjësve që kanë dalë në pension, ose që jetojnë në përkrahje sociale".

Neni 8

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"Vetëm përfaqësuesit e organeve qendrore të sindikatave që funksionojnë në shkallë republike, kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me Presidentin dhe Këshillin e Ministrave për problemet që lidhen me marrëdhëniet e punës, kushtet e jetesës, pensionet dhe përkrahjen sociale.

Vetëm përfaqësuesit e organeve drejtuese të sindikatave që funksionojnë në bazë dege, kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me ministrinë dhe organet e tjera qendrore për probleme që lidhen me marrëdhëniet e punës, kushtet e jetesës, pensionet dhe përkrahjen sociale.

Vetëm përfaqësuesit e organeve drejtuese të sindikatave që funksionojnë në bazë territori, kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me përfaqësuesit e organeve drejtuese të pushtetit lokal dhe punëdhënësit në atë territor për probleme që lidhen me marrëdhëniet e punës, kushtet e jetesës, pensionet dhe përkrahjen sociale.

Vetëm përfaqësuesit e organeve drejtuese të sindikatave në qendra pune kanë të drejtë të hyjnë në bisedime me përfaqësuesit e punëdhënësit në këto qendra pune për probleme që lidhen me marrëdhëniet e punës, kushtet e jetesës, pensionet dhe përkrahjen sociale".

Neni 9

Në pikën "b" të nenit 22 fjalët "200 veta" zëvendësohen me fjalët "300 veta".

Neni 10

Nenet 5 dhe 7 shfuqizohen.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.386, datë 9.12.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.